



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM) në suaza të projektit “Mbështetja për punësimin e të rinjve”, të finan cuar nga ana e Programi operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013” (IPA Komponenti IV), dhe në bazë të Planit operativ për shërbimet në tregun e punës dhe programeve e masave aktive për punësimin në vitin 2017, e boton :

THIRRJE PËR TENDER

Për organizimin dhe zbatimin e stërvitjes për profesionet e kërkuara në tregun e punës për personat e papunë deri në moshën 29 vjet, kërkues aktiv të punës në suaza të komponentit B “Stërvitje për aftësitë e kërkuara në tregun e punës”

Agjencia e Punësimit (APRM) ka qëllim që të ndajë marrëveshje për shërbime në organizimin e implementimin e “Stërvitjes për aftësitë e kërkuara në tregun e punës” në mbarë territorin e shtetit..

Kjo shpallje publike paraqet thirrje për ofertuesit dhe të interesuarit që të paraqiten në këtë tender dhe që kërkojnë sigurimin e stërvitjeve për një ose më tepër nga kurset e certifikuar të stërvitjeve siç vijojnë:

- Lot 01 - Titulli: “Komponenti B – Stërvitje për aftësitë e kërkuara në tregun e punës – Stërvitje për nëpunës në kontabilitet” për 100 kandidatë.
- Lot 02 – Titulli: “Komponenti B – Stërvitje për aftësitë e kërkuara në tregun e punës – Stërvitje për kozmetis” për 40 kandidatë
- Lot 03 - Titulli: “Komponenti B – Stërvitje për aftësitë e kërkuara në tregun e punës – Stërvitje për masazhist” për 40 kandidatë.
- Lot 04 – Titulli: “Komponenti B – Stërvitje për aftësitë e kërkuara në tregun e punës – Stërvitje për përkujdesës për persona të moshuar dhe të pafuqishëm në kushte shtëpiake” për 40 kandidatë.

Stërvitjet për aftësitë e kërkuara në tregun e punës do të realizohen nga ana e subjekteve juridike me programe të certifikuar për stërvitje.

Stërvitjet do të organizohen për 220 të rinj të papunë që janë paraqitur si kërkues aktiv të punës në APRM-së..

Të gjithë ofertuesit e interesuar mund të aplikojnë për një lot ose për disa lote nëpërmjet dorëzimit të vetëm një oferte për çdo lot.

Procedurat dhe afatet e aplikimit

Dosja e kompletuar tenderike në formë elektronike është e disponueshme vetëm me plotësimin e formularit të aplikimit që mund të gjendet në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit (APRM): www.avrm.gov.mk;
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale MPPS): www.mtsp.gov.mk.



This project is implemented by



Employment Service Agency



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Të gjitha subjektet juridike (provajderët e trajnimit) që janë të interesuar për të marrë pjesë në këtë tender duhet të dorëzojnë dosje tenderike dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që kërkohen. Dokumentet e tenderit patjetër duhet të dërgohen në adresën siç vijon, e cila është dhënë edhe në instruksionet e ofertuesve, shpalljen e furnizimit public dhe përshkrimin e detyrave të punës të theksuara në tender:

Agjencia e Punësimit (APRM)
Adresa: Rruga. "Vasil Gjorgov"
nr. 43, 1000 Shkup

Afata i dorëzimit të ofertave është e enjte 23 Marsh 2017 në orën 16:30.

Tenderi dhe të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen tenderike patjetër duhet të jenë të dorëzuara me shfrytëzimin e sistemit me kuvertë të dyfishtë, përkatësisht paketa ose kuverta e jashtme t'i përmbajë dy kuverta të mbyllura (njërën për ofertën teknike dhe tjetra për ofertën financiare) me këtë tekst: "Supporting employment of young people"; „Ref.no 12-7741/1-6.3 – Lot __“ dhe “Not to be opened before the tender opening session” / Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertave në pjesën e jashtme të kuvertës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jashtë afatit të mbylljes nuk do të shqyrtohen..

